

Ne perputhje me Nenin 28, paragrafi i 3-te i Ligjit 97/2007, Per Qendren Kombetare te Regjistrimit, ky dokument perben:

**AKT THEMELIMI  
DHE  
STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“GRAND TAXI” SH.P.K.**

Sot me date 31 Maj 2023, palet e meposhtme:

**Z.Kujtim KALE**, atesia Kujtim dhe amesia Elvira, lindur me 08.10.1979 ne Tirane e banues ne Tirane ne adresen: Rruga E Durresit, Nd. 81, H. 4, Ap. 26, Njesia bashkiake nr. 7, 1023, mbajtes i leternjoftimit nr. 034080311 me nr.personal H91008132K; dhe

**Shoqeria “Pick -Up” shpk**, shoqeri e regjistruar ne QKB me NUIS **L721150430**, me adrese ne Tirane, Dajt, Rr. “Mahmut Allushi”, Pallai LT-03, Kati 03 e perfaqesuar nga **Z.Gert HAKA**, atesia Perparim dhe amesia Liljana, lindur me 05.01.1983 ne Tirane e banues ne Tirane ne adresen: Rr. Sulejman Pasha, Nd. 12, H. 1, Njësia Bashkiake Nr. 9, 1016, mbajtes i pasaportes se SHBA nr.546214855.

vendosin te nenshkruajne kete Akt Themelimi dhe Statut per krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

**KAPITULLI I  
FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1. Shoqeria “**GRAND TAXI**” Sh.p.k. (ne vijim “Shoqeria”) krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij Statuti dhe Aktit te Themelimit.
- 1.2. Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emertimi**

- 2.1 Emertimi i Shoqerise eshte “**GRAND TAXI**” Sh.p.k..

**Neni 3 – Objekti i shoqerise**

- 3.1 Objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte: Sherbim taksi, program te veçante Busines Class me automjete te dezinjua, furgon shërbimi dhe turizmi, sherbim taksi te nje niveli bashkohor me nje nivel te larte, shërbimi dhe trajnimi te vazhdueshem te personelit te shërbimit (shofer), operator te vazhdueshem taksi me nje pakete te përshtatshme me mbi 15 automjete ne ndihme te mbrojtjes se ambientit dhe menaxhim te vazhdueshem te tregut, pasijen e automjeteve me GPS paisjeve dhe sistemit tone hitech dergimit te mjetit duke minimizuar kohen e pritjes, blerje, shitje, marrje me qira e dhenia me qira te automjeteve dhe mjeteve te transportit ne pergjithesi. Te gjitha aktivitetet e nevojshme dhe te favorshme per te arritur qellimin e biznesit te shoqerise ne perputhje me ligjin. Servis automjetesh (autovetura, kamiona, motoçikleta etj.), riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe elektrike te motorrit te mjeteve rrugore me motorr dhe rimorkiove, si dhe shitblerja e pjeseve te tyre. Ofrim sherbimi karikimi nepermjet karikuesve elektrike.

**Neni 4 – Selia**

- 4.1. Selia e Shoqerise eshte: Njesia Bashkiake Nr. 10, Rruga “Kristaq Mema”, Nd.2, Ap. 1, Tirane, Shqiperi.
- 4.2. Transferimi i selise se Shoqerise ne nje vend tjeter behet me vendimin e Asamblese se Ortakeve.
- 4.3. Asambleja e Ortakeve mund te vendose hapjen e filialeve, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne

qytete te tjera te Shqiperise.

#### **Neni 5 – Kohezgjatja e veprimtarise**

- 5.1. Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar.
- 5.2. Shoqeria mund te priset perpara ketij afati ose mund te ndryshoje kohezgjatjen e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

### **KAPITULLI II**

#### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

##### **Neni 6 – Kapitali themeltar**

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1,000 (nje mije) Leke.
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 2 (dy) kuota e gjitha e nenshkruara dhe e shlyera, me vlere nominale 500 Leke (peseqind Leke) dhe 500 Leke (peseqind Leke).

##### **Neni 7 - Kontributet**

- 7.1 Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar si me poshte:
  - **Z.Kujtim Kale** ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 500 Leke (peseqind leke) ne favor te shoqerise ne themelim e siper.
  - **Shoqeria "Pick -Up" shpk** ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 500 Leke (peseqind leke) ne favor te shoqerise ne themelim e siper.
- 7.2 Sipas kontributeve te mesiperme:
  - **Z.Kujtim Kale** zoteron 1 (nje) kuote qe i korrespondon me 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te Shoqerise;
  - **Shoqeria "Pick -Up" shpk** zoteron 1 (nje) kuote qe i korrespondon me 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te Shoqerise.

##### **Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar**

- 8.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Ortakut te Ortakeve.
- 8.2 Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjitha ortaket kane te drejten te nenshkruajne rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara. Ne rast se disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

##### **Neni 9 – Zvogelimi i kapitalit themeltar**

- 9.1 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese se Ortakeve. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

##### **Neni 10 – Transferimi i kuotave**

- 10.1 Kuotat jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.
- 10.2 Ne rast transferimi ne çdo lloj forme, si me shperblim ashtu edhe pa shperblim ne kuptimin me te gjere te fjales, duke perfshire ketu edhe dhurimin ne favor te subjekteve te tjere te ndryshem nga ortaket, kuotat duhet me pare t'i ofrohen ne parablerje ortakeve te tjere.
- 10.3 Ne nje rast te tille ortaku qe do te transferoje kuoten e tij duhet te njoftoj ortaket e tjere. me leter rekomande me kthim pergjigje, mbi synimin per shitje, duke percaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blesesit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet te gjitha kuotave te ofruar per shitje.
- 10.4 Ortaket do te kene ne dispozicion 15 (pesembedhjete) dite nga marrja e letres rekomande, per t'i komunikuar ortakut qe transferon kuotat, synimin e tyre per te ushtuar apo jo te drejten e parablerjes. Ne rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Ne rast se oferta pranohet nga disa ortake, kuotat e ofruara nga ortaku qe transferon kuotat, do te

ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zoterojnë, përveç rasti kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të treta plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

10.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak të trashëgimit *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pelqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pelqimi, kuotat mund t'u transferohen të treta plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

### KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

#### Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emrimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

#### Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë atë votë sa është numri i kuotave që ai zoteron.

12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

12.3 Ortaku nuk mund të leshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zoteron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

#### Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakut të Vetem/Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabel dhe inventarit.

13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pese për qind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me leter rekomandë me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve – dhe ekspertit kontabel (nese është emëruar), të paktën 15 (pese mbledhjet) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuoromit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.

13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të dës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tere kapitalin themeltar.

13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohej një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojnë me shumicë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilesuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojnë të paktën 51% (pese dhjetë e

nje perqind) te kapitalit themeltar.

- 13.8 Asambleja e Ortakeve vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, me voten pro te  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e ortakeve te pranishem qe zoterojne te pakten 51% (pesedhjete e nje perqind) te kapitalit themeltar. Ne te gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakeve merr vendime me shumice te thjeshte votash te ortakeve qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete perqind) te kapitalit themeltar.
- 13.9 Çdo Asamble drejtohet nga nje ortak ose ndonje person tjetër i caktuar nga vete Asambleja. Per pasqyrimin e vendimit Asambleja emerone nje Sekretar, qe mund te jete edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari.

#### **Neni 14 – Administrimi**

- 14.1 Shoqeria administrohet nga te pakten 1 (nje) Administrator i cili do te qendroje ne detyre deri ne shkarkim apo doreheqje ose per nje periudhe prej 5 (pese) vitesh. Administratori i pare i Shoqerise eshte emeruar **Krisilda Ali**, atesia Pajtim, lindur me 21.07.1997 ne Tirane e banuese ne Tirane, mbajtes i leternjofitimit nr. 032533441 me nr.personal J75721058V.
- 14.2 Perfaqesimi ligjor i Shoqerise i besohet Administratorit. Administratori mund te ushtroj te gjitha fuqite konform me sa parashikohet ne nenin 95 te Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare”.
- 14.3 Administratorët mund te emerone perfaqesues te posaçem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh.

#### **Neni 15 – Eksperti kontabel i autorizuar**

- 15.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakut te Vetem/Ortakeve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel te Shoqerise mund t'i besohet nje ose disa eksperteve kontabel te autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

### **KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor**

- 16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit.
- 16.2 Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicen e kerkuar nga Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare”.
- 16.4 Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

#### **Neni 17 – Fitimet**

- 17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara.
- 17.2 Asambleja mund te vendose edhe zbritje te veçanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

### **KAPITULLI V SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 18 – Prishja**

- 18.1 Shoqeria priset me perfundimin e afatit te parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet

e parashikuara nga ligji, ose me ane te nje vendimi te Asamblese se Ortakut te Vetem/Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.

18.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, vdekjes, ose falimentimit te ortakeve.

#### **Neni 19 – Likuidimi**

19.1 Ne rast prishje, Shoqeria duhet te likuidohet.

19.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja emerone nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.

19.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.

19.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcione me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

#### **Neni 20 - Zgjidhja e mosmarreshjeve**

20.1 Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij statuti dhe aktit te themelimit, si edhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis ortakeve (pervec atyre personale apo jashte Shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte ndermjet paleve te interesuara.

20.2 Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje miqesore te mosmarreshjes, ato do t'i besohen Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### **Neni 21 – Gjuha**

21.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut eshte hartuar ne 2 (dy) kopje ne gjuhen shqipe.

\* \* \*

### **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE “GRAND TAXI” SHPK**

**Kujtim KALE**

*Kujtim Kale*  


Shoqeria “Pick -Up” shpk

**Gert HAKA**

*GERT HAKA*  
